

**Bullizmi
kibernetik:**

**Kur Bullizmi
Vepron
Nëpërmjet
Internetit**



Dr. Juan Moisés de la Serna

Juan Moisés De La Serna

Bullizmi Kibernetik

Аннотация

Bullizmi kibernetik është një formë moderne e bullizmit nga i cili mund të preket kushdo, por ai bëhet sidomos shqetësues kur të prekurit janë minorenët. Bullizmi kibernetik është një formë moderne e bullizmit nga i cili mund të preket kushdo, por ai bëhet sidomos shqetësues kur të prekurit janë minorenët. Kjo guidë e shkurtër u jep përgjigje pyetjeve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me këtë temë diskutimi, përgjigje që çdo prind që ka fëmijë në moshë shkollore duhet t'i ketë mirë parasysh, si për shembull: çfarë është Bullizmi kibernetik? Si influencon ai në jetën e atij apo asaj që bëhet viktimë? A mund të parandalohet Bullizmi kibernetik? Dhe mbi të gjitha çfarë duhet bërë nëse fëmija jonë është viktimë e tij? Zbuloni të gjitha aspektet kyçe të Bullizmit kibernetik, në sajë edhe të rezultateve nga kërkimet e fundit shkencore të kryera në këtë fushë të psikologjisë.

Содержание

Parathënie	5
Falenderime	6
Përmbajtja	7
Kapitulli 1. HYRJE NË BULLIZMIN KIBERNETIK	8
Kapitulli 2. Çfarë është Bullizmi kibernetik?	12
Конец ознакомительного фрагмента.	19

Bullizmi kibernetik

Kur Bullizmi Vepron Nëpërmjet Internetit

Nga

Dr. Juan Moisés de la Serna

Përkthyer nga

2021

“Bullizmi kibernetik: Kur Bullizmi Vepron Nëpërmjet Internetit”

Shkruar nga Juan Moises de la Serna

Përkthyer nga Gentian Cane

Të drejtat e rezervuara © 2021 Juan Moises de la Serna

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Nuk lejohet riprodhimi i plotë apo i pjesshëm i këtij libri, as hedhja e tij në sistem informatik apo edhe transmetimi në çfarëdo lloj forme ose me çfarëdo lloj mjete, si elektronik, mekanik, me anë të fotokopjimit, regjistrimit apo mjeteve të tjera, pa autorizimin paraprak dhe me shkrim të botuesit. Shkelja e të drejtave të cituara sa më sipër mund të përbëjë vepër penale ndaj pronësisë intelektuale (neni 270 e në vijim të kodit penal).

Drejtohuni te C.E.D.R.O. (Qendra spanjolle për të drejtat e reprografisë) nëse do lindë nevoja për fotokopjim apo skanim të çdo lloj fragmenti apo copëze nga ky libër. Mund të kontaktoni C.E.D.R.O. me anë të sitit web www.conlicencia.com ose nëpërmjet telefonit në numrin 91 702 19 70/93 272 04 47.

Parathënie

Bullizmi kibernetik është një formë moderne e bullizmit nga i cili mund të preket kushdo, por ai bëhet sidomos shqetësues kur të prekur janë minorenët.

Kjo guidë e shkurtër u jep përgjigje pyetjeve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me këtë temë diskutimi, përgjigje që çdo prind që ka fëmijë në moshë shkollore duhet t'i ketë mirë parasysh, si për shembull: çfarë është Bullizmi kibernetik? Si influencon ai në jetën e atij apo asaj që bëhet viktimë? A mund të parandalohet Bullizmi kibernetik? Dhe mbi të gjitha, çfarë duhet bërë nëse fëmija jonë është viktimë e tij?

Zbuloni të gjitha aspektet kyçe të Bullizmit kibernetik, në sajë edhe të rezultateve nga kërkimet e fundit shkencore të kryera në këtë fushë të psikologjisë.

Falenderime

Përfitoj nga rasti që të shpreh falenderimet e mia ndaj të gjithë njerëzve që më ndihmesën e tyre kanë kontribuar në realizimin e këtij libri, në veçanti Dr. Abel González García, Drejtor i Departamentit të Kriminologjisë në Universitetin në Distançë të Madridit dhe Dr. Pilar Vecina, Drejtore e Departamentit të Neuropsikologjisë në “Institutin për Kërkim dhe Zhvillim Social të Sëmundjeve të Rralla”.

Përmbajtja

Parathënie

Falenderime

Përmbajtja

Kapitulli 1. HYRJE NË BULLIZMIN KIBERNETIK

Kapitulli 2. Çfarë është Bullizmi kibernetik?

Kapitulli 3. Profili i viktimës dhe i abuzuesit.

Kapitulli 4. Shenjat e Bullizmit kibernetik

Kapitulli 5. Pasojat nga Bullizmi kibernetik

Kapitulli 6. Si të sillemi me Bullizmin kibernetik?

Kapitulli 7. Ndërhyrja terapeutike në rastet e Bullizmit

kibernetik

Kapitulli 8. A është e mundur ta parandalojmë Bullizmin

kibernetik?

Kapitulli 9. Bullizmi kibernetik dhe mësimdhënësit

Kapitulli 10. Dhuna mbi bazë dixhitale

Konkluzione

Juan Moisés de la Serna.

Kushtuar prindërve të mi

Kapitulli 1. HYRJE NË BULLIZMIN KIBERNETIK

Natyrisht që duhet të keni dëgjuar nga mjete të ndryshme komunikimi që gjithmonë e më shumë të rinjtë po përfshihen në raste bullizmi përmes mediave dixhitale, për shkak të përdorimit tejet të lartë të këtyre mediave dhe sidomos të anonimatit që ofron rrjeti dixhital.

Bullizmi kibernetik konsiston në një akt poshtërimi, shantazhi apo edhe presioni që kryen një palë, e përbërë nga një apo shumë persona, ndaj një pale tjetër. Kjo gjë mund të ndodhë atëherë kur ata konsiderohen si “të ndryshëm”, për shembull nëse janë më të gjatë, më të shëndoshë në trup, apo nëse janë tifozë të një skuadre të caktuar futbollit...

Duke kqyrur rezultatet që na ofron Google në lidhje me tendencat e kërkimit për termin Bullizmi kibernetik, në të gjitha kuptimet e ndryshme që mbart ky term në mbarë botën nga 2004 deri në 2017-ën, mund të vihet re se vendin e parë me më shumë raste shqetësuese e zënë Filipinet, e ndjekur më pas nga Australia dhe Zelanda e Re. Shtetet e Bashkuara të Amerikës zënë vendin e shtatë ndërsa Spanja vendin e tridhjetë e gjashtë nga 45 vende që shfaqen në rezultatet e kërkimit në Google. Vendin e fundit në renditje e zë Turqia.

Ky rezultat nuk pasqyron numrin e rasteve të Bullizmit

kibernetik që hasen për çdo vend, por faktin sesa herë ky term është kërkuar në internet. Në realitet mund të ekzistojë një vend në të cilin hasen pak raste të Bullizmit kibernetik por popullata e atij vendi disponon njëfarë ndjeshmërie mbi këtë fenomen dhe si rrjedhojë në Google do të bëhen shumë kërkime mbi këtë term.

Në rastin e kundërt, mund të ekzistojë një vend ku Bullizmi kibernetik është institucionalizuar por ekziston një ndërgjegjësim i pakët në lidhje me këtë fenomen dhe si rrjedhojë në Google nuk bëhen shumë kërkime mbi një term të tillë.

Është për t'u theksuar, se midis dhjetë vendeve të para që bëjnë kërkime mbi këtë term në Google, pesë prej tyre janë vende të ashtuquajtura të botës së parë, dhe konkretisht janë Australia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja.

Madje vihet re edhe sesi është rritur dukshëm, në nivel global, përdorimi i këtij termi me kalimin e viteve, duke rezultuar në një rritje prej 65% të kërkimeve të kryera në vitin 2017 krahasuar me vitin 2004.

Duke bërë një analizë globale të ecurisë së kërkimit në Google në aspektin sezonal, mund të vihet në dukje se gjatë muajve të vjeshtës si shtatori dhe tetori kryhen më shumë kërkime në lidhje me fenomenin e Bullizmit kibernetik; ndërsa në muajt e pushimeve të verës e të dimrit si korriku dhe gushti, apo dhjetori dhe janari, kryhen më pak kërkime.

Raportohen edhe raste të Bullizmit kibernetik me përmbajtje seksuale, por kjo gjë nuk është ekskluzive. Në shumë raste

përmbajtja me natyrë seksuale nuk është synimi final i abuzuesit, por përdoret gjithmonë me qëllimin për të poshtëruar dhe shantazhuar viktimën.

<<Çfarë është Bullizmi kibernetik?

Bullizmi kibernetik është një formë keqtrajtimi dhe abuzimi që ndodh midis fëmijëve në moshën shkollore, karakterizohet nga përdorimi i komunikimit në hapësirën kibernetike për të realizuar përjashtimin total të viktimës nga grupet me të cilët bashkëjetojnë në shkollë.>>

Dr. Abel González García, Drejtor i Departamentit të Kriminologjisë, U.D.I.M.A. (Universiteti në Distançë i Madridit)

Është e pritshme që në të ardhmen, gradualisht me zhvillimin e teknologjisë dhe përhapjen e saj në shkallë më të lartë, e njëjta gjë do ndodhë edhe me avantazhet dhe disavantazhet nga përdorimi dhe keqpërdorimi i saj, duke përfshirë këtu mes të tjerash edhe Bullizmin kibernetik. Gjithsesi mbetet akoma shumë për të hulumtuar në këtë drejtim, edhe pse, në shumë raste, minoreni ndaj të cilit apo së cilës ushtrohet bullizëm, nuk e denoncon abuzuesin për vetë faktin se është i shantazhuar.

Pavarësisht situatës që karakterizohet nga skepticizmi dhe pasiguria, disa prej shteteve kanë miratuar dhe zbatuar masa për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndetin, duke marrë parasysh se në disa raste minoreni apo minorenia arrijnë deri në vetëvrasje si pasojë e dëshpërimit duke mos ditur se si të dalë nga një situatë e tillë.

<< A është rritur Bullizmi kibernetik vitet e fundit?

Vitet e fundit në fakt duket se po vihet re një rritje e fenomenit të Bullizmit kibernetik si pasojë e një intensifikimi të përdorimit të mjeteve të komunikimit në internet, dhe sidomos i rrjeteve sociale (Twitter, Facebook, Ask.fm, WhatsApp, etj.).

Ditët e sotme gati 100% e fëmijëve të moshës 10-11 vjeç e lart përdorin rregullisht një lloj mjeti të teknologjisë.

Gjithashtu, në mënyrë logjike, agresioni po zhvendoset në drejtim të kësaj lloj marrëdhënieje pasi është më e lehtë kryerja deri në fund e këtyre veprimeve.>>

Dr. Abel González García, Drejtor i Departamentit të Kriminologjisë, U.D.I.M.A.

Bëhet fjalë për një problem shumë aktual, për të cilin flitet menjëherë në mjetet e komunikimit; vetëm kur një polic arreston një agresor që vepron në internet ose kur viktimat e bullizmit kryejnë vetëvrasje. Vetëm në raste të tilla ekstreme bëhet evident ky lloj fenomeni, që vitet e fundit po agravon gjithnjë e më tepër.

Një fenomen rreth të cilit as prindërit as mësuesit siç duket, nuk janë të përgatitur sa duhet, nuk janë në gjendje të kapin shenjat e para tek viktimat që pëson bullizëm, dhe nuk dinë si të reagojnë ashtu siç duhet për ta eliminuar fenomenin.

Në këtë kuadër disa shtete kanë vënë në zbatim politika për mbrojtjen e minoreneve dhe për parandalimin e Bullizmit kibernetik, pikërisht në përpjekje të frenimit të përhapjes në shkallë të gjerë të këtij fenomeni që me sa duket është bërë i kohës.

Kapitulli 2. Çfarë është Bullizmi kibernetik?

Termi Bullizëm kibernetik, i njohur edhe si cyberbullying (sajbërbulling) në anglisht, është një formë e shtuar e bullizmit që ushtrohet nëpërmjet mjeteve të teknologjisë, si telefoni apo interneti, me anë të së cilit një person (abuzuesi ose agresori) kërkon të dobësojë apo shkatërrojë vetëvlerësimin e një personi tjetër (ndaj të cilit ushtrohet abuzimi apo agresioni), duke i dërguar mesazhe kërcënuese, intimiduese apo shantazhuese me anë të emailit apo messenger-it (të llojit chat apo messenger), S.M.S-ve apo të rrjeteve sociale.

Para se të rritej përdorimi i teknologjisë në shkallë të gjerë, fenomeni i bullizmit apo i agresionit konsistonte në takimin fizik mes abuzuesit dhe të abuzuarit, ku përdroreshin fyerje, kërcënime dhe përçmime, nga ku pastaj ekzistonte mundësia që e gjitha kjo të shpërthente në sulm fizik me qëllim që abuzuesi të arrinte atë çka dëshironte.

Disa ekspertë vënë në dukje një dallim midis termit Ngacmimi kibernetik, që konsiderohet i tillë kur kryhet me anë të përdorimit të teknologjive të reja, dhe Bullizmi kibernetik, në të cilin futen vetëm ato raste kur agresioni ndodh mes minoreneve dhe me anë të mjeteve të teknologjisë.

Sidomos shqetësues paraqitet fakti që numri i rasteve mes

adoleshentëve është gjithnjë e në rritje, për shembull në Spanjë gati një e treta e minoreneve të moshës 17 vjeç pohojnë se kanë qenë viktimat të Bullizmit kibernetik dhe madje 19% e tyre rrëfejnë se kanë ofenduar një njeri tjetër përmes internetit. Në Amerikën e Jugut, sipas të dhënave të UNESCO-s, mbi 50% e nxënësve të shkollës fillore kanë qenë viktimat të bullizmit në shkollë, një rrezik që shtohet edhe më shumë përmes internetit.

Një realitet, që disa studime nxjerrin në pah, për një student në tre mbi moshën 17 vjeç në Shtetet e Bashkuara; ndërkohë që kjo shifër në mbarë globin shkon nga 17 në 48%.

Edhe pse shumë serioz dhe me shumë pasoja, sidomos kur ata që përfshihen në të janë minorene, ky fenomen shpesh nuk konsiderohet si ndër krimet informatike më të dëmshme dhe të pazakonta siç janë për shembull vjedhja e identitetit apo spamerat...

Më kujtohet ende sot e kësaj dite, kur gjatë një qëndrimi me punë kërkimore në Universitetin e Guadalaharës (Meksikë), në stendën e njoftimeve në krah të derës së hyrjes ishte gjithmonë i afishuar një njoftim që bënte të ditur se në rast se merrej ndonjë email nga Banamex-i (një prej bankave më të mëdha dhe më të përhapura në Meksikë), nuk duhet të kthehej asnjë përgjigje.

Në fakt, në shpjegimet e emailit të dërguar kërkohet fjalëkalimi për të riaktivizuar llogarinë bankare, dhe që, për këtë arsye, dilte si nevojë të jepeshin të dhënat e llogarisë, përveç atyre personale.

“Kurthi” konsistonte në faktin që përdoruesit drejtoheshin, me

anë të një linku që hapej sapo klikohej në email, në një faqe të fallsifikuar por që ishte identike me faqen zyrtare.

Me të futur të dhënat personale, të dhënat mbi llogarinë rrjedhëse bankare dhe pasi klikohej tek tasti “dërgo”, merrej më pas një mesazh ku shkruhej se gjithçka ishte në rregull dhe se përdoruesit mund të vazhdonin të përdornin normalisht llogarinë rrjedhëse.

Ajo që nuk dihej ishte se atë email nuk e kishte dërguar asnjëherë banka dhe se të dhënat e futura “me dëshirë” ishin bërë të aksesueshme nga vjedhësit e identitetit dhe kriminelët e fushës kibernetike.

Një krim që më përpara kryhej nëpërmjet postës, kur kërkoheshin të dhënat për abonimin në një revistë apo gazetë dhe që sot vazhdon të ndodhë nëpër rrugë, kur një person, duke u hequr si anëtar i ndonjë institucioni në fushën mbështetëse, kërkon të dhëna personale dhe të llogarisë rrjedhëse për një abonim të supozuar, kur në realitet ai institucion nuk ka ngarkuar kurrë një person të tillë për të mbledhur këto të dhëna.

Rezultati final është po i njëjlloti, të jepen “me dëshirë” të dhëna personale dhe bankare por pa ditur sesi do të përdoren më pas.

Në ndryshim nga krimet e tjera informatike, ku agresori mundohet të mos lërë “gjurmë” për veprimet që kryen, për shembull duke marrë identitetin e dikujt tjetër, ose duke u futur në informacionet personale dhe në numrin e llogarisë rrjedhëse; në rastin e Bullizmit kibernetik, jemi para një përballje direkte

mes viktimës dhe agresorit, pavarësisht se i dyti ruan anonimatin, dhe kjo sepse agresori do që viktimë e tij ta dijë se ai është aty, dhe që viktimë nuk mund të bëjë dot gjë për ta evituar, si formë kërcënimi dhe ndëshkimi, tregues që shprehin fuqinë e agresorit.

Rrallë ndodh që Bullizmi kibernetik të ushtrohet nga më shumë se një person, në ndryshim nga bullizmi në përgjithësi apo bullizmi në mjediset shkollore si edhe nga ngacmimet në vendin e punës që mund të kryhen nga dy apo më shumë persona.

Një dallim tjetër midis Bullizmit kibernetik dhe agresionit direkt është se, në rastin e dytë, personat e tjerë, për shembull ata që janë shokë shkolle apo kolegë pune, mund të shërbejnë si burim mbështetjeje të situatës duke u bërë kështu më shumë sesa dëshmitarë të thjeshtë të ngacmimeve. Në shumë situata, në fakt, këta marrin pjesë duke e nxitur agresorin ose madje edhe duke e justifikuar, kështu që ai të ndihet i legjitimuar në veprimet që kryen duke mos marrë asnjë lloj qortimi apo reagimi në formë refuzimi nga ana e grupit.

Nga ana tjetër, në rastet e Bullizmit kibernetik, “tjetri” nuk ekziston, pasi edhe agresori nuk ka dëshirë për popullaritet apo për të dalë në dukje para të tjerëve, tjetri thjesht zhduket, kështu që sjellja agresive vazhdon dhe përforcohet me ndjesinë e fuqisë që agresori provon kur sheh se po i bën keq një personi.

<<Kur dhe si duhet të veprojë policia në rastet e Bullizmit kibernetik?

Kur është e sigurt se një person ka qenë ose është viktimë e një situatë të këtillë, ashtu siç u përshkrua pak më sipër, del si nevojë

të paraqiten në polici provat përkatëse për të kryer një denoncim ndaj personit apo profilit të personit që ka bërë kërcënimin. Duhet të përshkruhen aktet e ngacmimit apo intimidimit që janë kryer ndaj personit denoncues, gjithashtu edhe të përcaktohet periudha kohore gjatë së cilës janë kryer këto veprime.>>

Pilar Vecina, Drejtore e Departamentit të Neuropsikologjisë në Institutin për Kërkim dhe Zhvillim Social të Sëmundjeve të Rralla.

Ekzistojnë dallime në zgjidhjen e rasteve të Bullizmit në përgjithësi dhe rasteve të Bullizmit kibernetik; në rastin e parë, denoncimi ndaj një shefi, apo në aspektin e shkollës, ndaj një mësuesi, mund të jetë e mjaftueshme për t'i dhënë fund problemit, ndërsa në rastin e dytë nuk ekziston një autoritet definitiv që mund ta frenojë një krim të tillë. Prandaj shumë shtete po vënë në zbatim politika të reja, në përpjekje për të frenuar këto lloj aktesh, sidomos ato që kryhen ndaj minoreneve nga të rriturit, të cilët kërkojnë të arrijnë shumë më shumë se sa thjesht një poshtërim të viktimës, gjë që mund të shtyjë në vetëvrasje ata që nuk janë në gjendje të durojnë peshën e shantazhit në të cilin janë vënë.

Nga shumë shtete janë hedhur disa propozime në tavolinë, që nga krijimi i një trupe policie të specializuar, me përgjegjësinë për të identifikuar agresorët, me qëllimin për ta zhdukur anonimatin e tyre në internet, apo ligje të natyrës penale, të hartuar posaçërisht për të trajtuar këto lloj rastesh, në të cilat arrihet madje edhe të vendoset një dënim me burg për abuzuesin

kibernetik, si mënyrë për “ta penguar” këtë fenomen, por edhe si njëfarë ndëshkimi për ata që kryejnë këtë krim.

Nga sa u tha deri më tani, është e qartë se mekanizmi për të frenuar Bullizmin kibernetik është shumë më kompleks nga vetë fenomeni dhe sjellja, ja përse denoncimi duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që autoritetet kompetente të mund të veprojnë dhe të evitojnë kështu pasoja akoma më të rënda.

<<Kur dhe si duhet të veprojnë organet gjyqësore në rastet e Bullizmit kibernetik?

Në këtë rast, varet sa sa të rënda dhe sa të shtrira në kohë janë faktet. Dihet që minorenët nuk mund të gjykohen dhe as të dënohen, duke pasur parasysh moshën 14 vjeçare, kështu që masat që merr organi i drejtësisë do të varen edhe nga moshja e agresorëve. Për shembull në rastin e fenomenit të grooming, prostituimit me pagesë që bën një minoren për llogari të një rrituri (që hiqet si minoren), duke vendosur një lidhje socio-emocionale me qëllim abuzimi me të, dënimet janë të ndryshme, pasi një i rritur është fajtor për veprimet intimiduese, shumë herë më shumë nëse e krahasojmë me një adoleshent 16 vjeç që ka dërguar ndonjë foto erotike të viktimës.

Në të gjitha mënyrat, e rëndësishme është të bëhet denoncimi derisa drejtësia të shkojë deri në fund, pasi identiteti i viktimës dëmtohet shumë, pavarësisht llojit të Bullizmit kibernetik të cilit i referohemi.>>

Pilar Vecina, Drejtore e Departamentit të Neuropsikologjisë

në Institution për Kërkim dhe Zhvillim Social të Sëmundjeve të Rralla.

Конец ознакомительного фрагмента.

Текст предоставлен ООО «ЛитРес».

Прочитайте эту книгу целиком, [купив полную легальную версию](#) на ЛитРес.

Безопасно оплатить книгу можно банковской картой Visa, MasterCard, Maestro, со счета мобильного телефона, с платежного терминала, в салоне МТС или Связной, через PayPal, WebMoney, Яндекс.Деньги, QIWI Кошелек, бонусными картами или другим удобным Вам способом.